



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.458/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Blerim Dina - Kryetar, – panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “DHW Kosova” SH.P.K – Prishtinë, kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull : “Furnizim me pajisje të instrumentit GPS dhe Total Station” me nr. të prok: 632- 20 -3153- 1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Gjakovë, më datën: 20.08.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “DHW Kosova” SH.P.K Prishtinë, kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me pajisje të instrumentit GPS dhe Total Station” me nr. të prok: 632- 20 -3153- 1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Gjakovë.

II. OBLIGOHET, autoriteti kontraktues /Komuna e Gjakovës/ ti bëj ndryshimet e nevojshme në dosjen e tenderit në pajtim me dispozitat ligjore dhe të zgjasë afatin për ofertë duke vepruar konform nenit 53.7 të LPP-së, dhe të marrë parasysh rekomandimet e dhëna në raportin e ekspertizës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pajisje të instrumentit GPS dhe Total Station ”- me nr. të prok: 632- 20 -3153- 1-2-1.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “DHW Kosova” SH.P.K- Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues “DHW Kosova” SH.P.K - Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP me 09.07.2020 me nr. 458/20, kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me pajisje të instrumentit GPS dhe Total Station” - me nr. të prok: 632- 20 -3153- 1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ “Komuna Gjakovë”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin:1. pika 1, 2, dhe 3, nenin 7, pika 1, 2, 3, 4, 6, nenin 9 pika 1, nenin 10 pika 1, 2, 3, nenin 28 pika 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, të LPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 20.07.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues-teknik të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues-teknik i prokurimit në raportin e dt: 28.07.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues “DHW Kosova” SH.P.K – Prishtinë se AK për antenën e GNSS ka vendosur specifikime shumë të ulëta dhe se për komponentin po ashtu të rëndësishme që është softueri nuk ka paraqitur kërkesa apo specifikime. AK në dokumentin paramasa ka paraqitur specifikimet teknike për pozicionin 1, përkatësisht për Antenën e GNSS ka paraqitur specifikime teknike minimale që duhet plotësuar. Në lidhje me kërkesat ku OE ankues pretendon se AK kërkon produkt bazik dhe nga më të lirët, sqarojmë se është në përgjegjësinë e AK-së që të kërkoj pajisjet që kanë nevojë, e me të cilat mund të përmbush funksionet pa ndonjë kufizim së paku brenda periudhës së amortizimit të pajisjes. Pra, AK duhet të hulumtojë tregun dhe të kërkojë produkte që i përmbushin nevojat dhe të specifikojë kërkesat se çka duhet të përmbush pajisja dhe specifikimet minimale për këto pajisje. Specifikimet nuk duhet të kenë elemente që kufizojnë konkurrencën ose orientohen tek një prodhues apo pajisje specifikime. Në lidhje me kërkesat për ndjekje të sinjaleve dhe këndin e pjerrtësisë, AK përmes sqarimeve ka potencuar se këto janë kërkesa minimale që plotësohen nga të gjithë prodhuesit në treg. Për aq sa është vlerësuar nga AK se këto kërkesa edhe pse minimale janë të mjaftueshme për të përmbushur qëllimin, e një specifikimi të tillë nuk është. Në

lidhje me mungesën e kërkesave dhe specifikimeve, është evidente që kërkesat dhe specifikimet nuk i përmbajnë disa nga elementet bazike që duhet ti kenë këto pajisje. Sikurse është numri i kanaleve, portet dhe protokollat e komunikimit si dhe kërkesat softuerike për përpunimin e informacionit gjatë matjeve gjeodezike në teren. AK duhet të vendos kërkesat minimale për antenën, marrësin dhe softuerin me qëllim që të garantohet se do të furnizohen me pajisje që duhet të përmbushin kërkesat dhe në këtë formë të arrihet qëllimi i aktivitetit të prokurimit. Andaj, sipas sqarimeve të dhënat e mësipërme, pretendimi ankimor është pjesërisht i qëndrueshëm.

Përgjigje në Pretendimin nr. 2; OE ankues më tej pretendon se specifikimi i paraqitur nga AK për kontrollerinë është në kundërshtim me dispozitën e LPP-së për specifikimet teknike pasi që kanë vendosur kërkesa diskriminuese, konkretisht sistemin operativ Windows dhe memorien, si dhe nuk ka specifikuar elementet kryesore që nevojiten për një pajisje të tillë sikurse janë GPS dhe software. AK në dokumentin paramana ka paraqitur specifikimet teknike për pozicionin 1 përkatësisht kontrollerinë e antenës GNSS. a) Fillimisht, në lidhje me këtë pajisje specifikimi i kërkesave funksionale dhe teknike është minimal dhe i paqartë, për nevojat që duhet të përmbush pajisja e kërkuar. Dhe përshkrimi si i tillë nuk jep një shpjegim të qartë se çka kërkohet. Pjesa ku është konfuze është Memoria, konkretisht AK ka specifikuar akronimin “RMA”. Më tej, AK është dashur të specifikojë kërkesat elementare dhe funksionale që lidhen për këtë pajisje sikurse janë: i. Të specifikohet që kërkohet kontrollori dedikuar për grumbullimin e informatave në teren gjatë procesit të matjeve dhe jo tablet i thjeshtë (nëse ky është qëllimi i AK-së. Ii. Të specifikohen protokollat e komunikimit; GSM, Wifi, Bluetooth. iii. Më tej do të duhej të përshkruhet madhësia e ekranit në inch, apo intervali i madhësisë së ekranit nga sa deri në sa inch në mënyrë që të mund të jetë kërkesa sa më gjithëpërfshirëse. iv. Në fund, pjesa dërmuese e pajisjeve të tilla kanë edhe kamerë (nëse AK konsideron të nevojshme), ku do të duhej të specifikohet së paku rezolucioni minimal i kërkuar. Kërkesat e mësipërme janë disa nga elementet thelbësore që një pajisje e tillë duhet ti ketë. Andaj, vendosja e kërkesave funksionale dhe specifikimeve më të detajuara teknike janë të nevojshme.) Sa i përket pjesës së pretendimit që lidhet me elementet: sistemi operativ Windows 10 dhe hapësira memorizuese, sqarojmë: në tregun e pajisjeve të tilla, jo vetëm modele të caktuara përmbushin këto dy elemente. Eksperti teknik ka hulumtuar tregun e pajisjeve të tilla dhe bazuar në informacionet e gjetura, pajisjet të më shumë se dy prodhuesve nuk përmbushin kërkesat e tilla, rrjedhimisht kërkesat e tilla bien në kundërshtim me dispozitat e LPP-së ku ndalohen kërkesat apo specifikimet që reduktojnë apo eliminojnë konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminojnë në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik. Aq më tepër kur kërkesa për sistem operativ nuk limiton në funksionet e AK-së përmbledhjen dhe shkëmbimin apo bartjen e të dhënave në pajisje tjera sikurse mund të jenë kompjuterët e zyrës. AK në këtë rast do të mund ta përkufizonte kërkesën që sistemi operativ kërkohet që të jetë Windows 10 apo ekuivalent me kusht që të mundësojë komunikimin dhe bartjen e

të dhënave në pajisje me sistemin operativ Windows 10. Në këtë formë AK sigurohet që pajisja me të cilën furnizohet i përmbush nevojat e institucionit dhe nuk limitohet në një pajisje apo prodhues. Ndërsa Ram memoria dhe kapaciteti/hapësira e memories janë në limitet maksimale të pajisjeve të tilla që janë në aktualisht në treg dhe si të tilla përjashtojnë pjesën dërmuese të pajisjeve. Kapaciteti/hapësira memorizuese sipas sqarimeve të dhëna nga AK është e nevojshme për ruajtjen e të dhënave nga matjet në teren dhe pastaj bartjet në kompjuter. Kjo do të mund të bëhej edhe nëse pajisja ka memorie shembull 32 GB për shkak se të dhënat grumbullohen nuk janë kapacitet të mëdha, dhe kjo do të mund të menaxhohej edhe duke bërë transferime në intervale të zakonshme dhe jo të grumbullohen shembull matjet e bërë në shumë herë. Po ashtu, një opsion që mund të merret në konsideratë është edhe vendosja memories së jashtme. Bazuar në sqarimet e dhëna në të dy pikat, pretendimi ankimor është i qëndrueshëm. Eksperti teknik ka dhënë sqarimet e mësipërme me qëllim të trajtimit të pretendimeve dhe për të udhëzuar AK-në që të adresojë korrigjimet në frymën e parimeve të legjislacionit të prokurimit publik në Kosovë, për të arritur qëllimin e këtij aktiviteti duke udhëhequr procedurën që garanton qasje gjithëpërfshirëse. Sipas sqarimeve të më sipërme, AK do të duhej të specifikoj kërkesat thelbësore që lidhen me pajisjet e kërkuara. Kërkesat dhe specifikimet se çfarë funksione duhet të kryejnë pajisjet, do të siguronte AK-në që përmes këtij projekti arrin qëllimin e paracaktuar duke përdorë në mënyrë efikase dhe transparente fondet publike. Më tej, duke u bazuar në parimet dhe dispozitat e LPP-së ku precizohet që kërkesat dhe specifikimet teknike duhet të ofrojnë qasje të barabartë për tenderuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të paarsyeshme në hapjen e konkurrencës, rekomandohet që AK të ndërmerr masa për korrigjimin e dosjes së tenderit në mënyrë që ofrojë qasje sa më të mirë për të gjithë OE.

Mendimi i ekspertëve shqyrtues/teknik: Duke u bazuar në sqarimet e cekura në raport, Eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues ankesa e OE "DHË Kosova" SH.P.K, të aprovet pjesërisht si e bazuar. Më tej, propozohet që të obligohet AK të bëjë korrigjimet sipas sqarimeve të dhëna më lartë dhe të bëhet zgjatja e afatit për dorëzimin e ofertave konform dispozitave të LPP-së.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 28.07.2020 me raportin e ekspertizës.

Operatori Ekonomik me datë: 29.07.2020 me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 19.08.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për

kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues/teknik të prokurimit dhe të gjithë parashtrësit e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues "DHW Kosova" SH.P.K – Prishtinë se AK ka për antenën e GNSS ka vendosur specifikime shumë të ulëta dhe se për komponentin po ashtu të rëndësishme që është softueri nuk ka paraqitur kërkesa apo specifikime. AK në dokumentin paramasa ka paraqitur specifikimet teknike për pozicionin 1, përkatësisht për Antenën e GNSS ka paraqitur specifikime teknike minimale që duhet plotësuar. Paneli Shqyrtues konform ekspertit teknik sqaron se në lidhje me kërkesat ku OE ankues pretendon se AK kërkon produkt bazik dhe nga më të lirët, vlerëson se është në përgjegjësinë e AK-së që të kërkoj pajisjet që kanë nevojë, e me të cilat mund të përmbush funksionet pa ndonjë kufizim së paku brenda periudhës së amortizimit të pajisjes. Pra, AK duhet të hulumtojë tregun dhe të kërkojë produkte që i përmbushin nevojat dhe të specifikojë kërkesat se çka duhet të përmbush pajisja dhe specifikimet minimale për këto pajisje. Specifikimet nuk duhet të kenë elemente që kufizojnë konkurrencën ose orientohen tek një prodhues apo pajisje specifikime. Në lidhje me kërkesat për ndjekje të sinjaleve dhe këndin e pjerrtësisë, AK përmes sqarimeve ka potencuar se këto janë kërkesa minimale që plotësohen nga të gjithë prodhuesit në treg. Për atë që është vlerësuar nga AK se këto kërkesa edhe pse minimale janë të mjaftueshme për të përmbushur qëllimin, e një specifikimi të tillë nuk është. Në lidhje me mungesën e kërkesave dhe specifikimeve, është evidente që kërkesat dhe specifikimet nuk i përmbajnë disa nga elementet bazike që duhet të kenë këto pajisje. Gjithashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit teknik sqaron se sikurse është numri i kanaleve, portet dhe protokollat e komunikimit si dhe kërkesat softuerike për përpunimin e informacionit gjatë matjeve gjeodezike në teren. AK duhet të vendos kërkesat minimale për antenën, marrësin dhe softuerin me qëllim që të garantohet se do të furnizohen me pajisje që duhet të përmbushin kërkesat dhe në këtë formë të arrihet qëllimi i aktivitetit të prokurimit. Andaj, pretendim ankimor është pjesërisht i qëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues "DHW Kosova" SH.P.K – Prishtinë se specifikimi i paraqitur nga AK për kontrollerinë është në kundërshtim me dispozitën e LPP-së për specifikimet teknike pasi që kanë vendosur kërkesa diskriminuese, konkretisht sistemin operativ Windows dhe memorien, si dhe nuk ka specifikuar elementet kryesore që nevojiten për një pajisje të tillë sikurse janë GPS dhe software. Paneli Shqyrtues konform ekspertit teknik sqaron se AK në dokumentin paramasa ka paraqitur specifikimet teknike për pozicionin 1 përkatësisht kontrollerinë e antenës GNSS. a) Fillimisht, në lidhje me këtë pajisje specifikimi i kërkesave funksionale dhe teknike është minimal dhe i paqartë, për nevojat që duhet të përmbush pajisja e kërkuar. Dhe përshkrimi si i tillë nuk jep një shpjegim të qartë se çka kërkohet. Pjesa ku është konfuze është Memoria, konkretisht AK ka specifikuar akronimin "RMA". Më tej, AK është dashur të specifikojë kërkesat elementare dhe funksionale që lidhen për këtë pajisje sikurse janë: i. Të specifikohet që kërkohet kontrollori

dedikuar për grumbullimin e informatave në teren gjatë procesit të matjeve dhe jo tablet i thjeshtë (nëse ky është qëllimi i AK-së. Ii. Të specifikohen protokollet e komunikimit; GSM, Wifi, Bluetooth. iii. Më tej do të duhej të përshkruhet madhësia e ekranit në inch, apo intervali i madhësisë së ekranit nga sa deri në sa inch në mënyrë që të mund të jetë kërkesa sa më gjithë përfshirëse. iv. Në fund, pjesa dërmuese e pajisjeve të tilla kanë edhe kamerë (nëse AK konsideron të nevojshme), ku do të duhej të specifikohet së paku rezolucioni minimal i kërkuar.

Gjithashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit teknik sqaron se kërkesat e mësipërme janë disa nga elementet thelbësore që një pajisje e tillë duhet ti ketë. Andaj, vendosja e kërkesave funksionale dhe specifikimeve më të detajuara teknike janë të nevojshme.) Sa i përket pjesës së pretendimit që lidhet me elementet: sistemi operativ Windows 10 dhe hapësira memorizuese, sqarojmë: në tregun e pajisjeve të tilla, jo vetëm modele të caktuara përmbushin këto dy elemente.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit teknik sqaron se ka hulumtuar tregun e pajisjeve të tilla dhe bazuar në informacionet e gjetura, pajisjet të më shumë se dy prodhuesve nuk përmbushin kërkesat e tilla, rrjedhimisht kërkesat e tilla bien në kundërshtim me dispozitat e LPP-së ku ndalohen kërkesat apo specifikimet që reduktojnë apo eliminojnë konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminojnë në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik. Aq më tepër kur kërkesa për sistem operativ nuk limiton në funksionet e AK-së përmbledhjen dhe shkëmbimin apo bartjen e të dhënave në pajisje tjera sikurse mund të jenë kompjuterët e zyrës. AK në këtë rast do të mund ta përkufizonte kërkesën që sistemi operativ kërkohej që të jetë Windows 10 apo ekuivalent me kusht që të mundësojë komunikimin dhe bartjen e të dhënave në pajisje me sistemin operativ Windows 10. Në këtë formë AK sigurohet që pajisja me të cilën furnizohet i përmbush nevojat e institucionit dhe nuk limitohet në një pajisje apo prodhues. Ndërsa Ram memoria dhe kapaciteti/hapësira e memories janë në limitet maksimale të pajisjeve të tilla që janë në aktualisht në treg dhe si të tilla përjashtojnë pjesën dërmuese të pajisjeve. Kapaciteti/hapësira memorizuese sipas sqarimeve të dhëna nga AK është e nevojshme për ruajtjen e të dhënave nga matjet në teren dhe pastaj bartjet në kompjuter. Kjo do të mund të bëhet edhe nëse pajisja ka memorie shembull 32 GB për shkak se të dhënat grumbullohen nuk janë kapacitet të mëdha, dhe kjo do të mund të menaxhohej edhe duke bërë transferime në intervale të zakonshme dhe jo të grumbullohen shembull matjet e bërë në shumë herë. Po ashtu, një opsion që mund të merret në konsideratë është edhe vendosja memories së jashtme. Andaj, pretendim ankimor në të dy pikat është i qëndrueshëm.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit teknik vlerëson se ka dhënë sqarime për të udhëzuar AK-në që të adresojë korrigjimet në frymën e parimeve të legjislacionit të prokurimit publik në Kosovë, për të arritur qëllimin e këtij aktiviteti duke udhëhequr procedurën që garanton qasje gjithëpërfshirëse. Andaj, AK do të duhej të specifikoj kërkesat thelbësore që lidhen me pajisjet e kërkuara. Kërkesat dhe specifikimet se çfarë funksione duhet të

kryejnë pajisjet, do të sigurojnë AK-në që përmes këtij projekti arrijnë qëllimin e paracaktuar duke përdorë në mënyrë efektive dhe transparente fondet publike. Gjithashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit teknik sqaron se bazuar në parimet dhe dispozitat e LPP-së ku precizohet që kërkesat dhe specifikimet teknike duhet të ofrojnë qasje të barabartë për tenderuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të paarsyeshme në hapjen e konkurrencës, rekomandohet që AK të ndërmerr masa për korrigjimin e dosjes së tenderit në mënyrë që ofrojë qasje sa më të mirë për të gjithë OE.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve ankimore, si dhe sqarimeve të ekspertit teknik vlerëson se autoriteti kontraktues me rastin e përpilimit të dosjes së tenderit ka caktuar kërkesa të cilat do të ndikonin në reduktimin apo eliminimin e konkurrencës në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që konform nenit 53.7 të LPP-së të zgjas afatin për ofertë dhe ti bëjë ndryshimet e nevojshme në dosje të tenderit dhe njëherit duke vepruar në pajtim me sqarimet e dhëna nga eksperti teknik.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim Dina

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK "Komuna Gjakovë" (KGJ),
- 1x1 OE DHW Kosova" SH.P.K – Prishtinë ,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.